

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit K. K. nga fshati Ll., KK. P., për shkak se ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.407-2/2010 të dt.08.06.2010, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur në praninë e prokurorit të shtetit Enver Krasniqi dhe të akuzuarit K.K., pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 13.05.2015, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë aktgjykim, i cili u përpilua me datën 01.06.2015,

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K.K., nga i ati A. dhe e ëma H., e vajzërisë K., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin Ll., KK. P., ku edhe tani jeton, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike – rast social, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, më parë nuk ka qenë i dënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 02.01.2010, rreth orës 08:20, rreth orës 08:20, në udhëkryqin e rrugëve “...” dhe “...”, afër shtëpisë së shëndetit në P., i pandehuri, K.K., duke drejtuar automjetin e tipit “Opel Ascona”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit *targat e regjistrimit...*, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që, duke mos i respektuar rregullat e komunikacionit, është kyçur në mënyrë të pasigurt në rrugën me përparësi kalimi, në kundërshtim me nenin 46 të LPSKRR-së, me ç’rast me pjesën e përparme të automjetit ka goditur, automjetin e tipit, “Golf 19 E”, ngjyrë e kuqe, me targa *targat e regjistrimit...*, të cilën e drejtonte, tani i dëmtuari J.M., pjesën anësore të anës së majtë dhe nga kjo goditje automjeti “Golf 19 E”, është sjellur në rrugë dhe me pjesën anësore të pasme të anës së djathtë, godet këmbësorin, A.K., i cili ishte duke ecur rrugës “...”, me ç’rast lëndim të rëndë trupor ka pësuar i dëmtuari, A.K., ndërsa drejtuesi i veturës “Golf 19 E”, J.M. dhe pasagjeri i tij J.M., kanë pësuar lëndime të lehta trupore,-

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 3,34,41,42,43,44,64 dhe nenit 297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, i shqipton:

D Ë N I M M E K U S H T

I. Të akuzuarin K.K. e dënon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej **1 (një) viti**, në qoftë se i akuzuari gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.

II. Të dëmtuarit: A.(R.) K. nga P., rr. "...", hyrja 2, nr.2, si dhe J. e J.M., që të dy nga fshati D., KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

III. I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, pasi që i njëjti është shfrytëzues i ndihmës sociale.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.407-2/2010 të dt.08.06.2010, ka akuzuar K.K. nga fshati Ll., KK. P., për shkak se ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësorë më dt. 13.05.2015, gjatë së cilës u dëgjuan prokurori i shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari K.K.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori shtetit.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 326 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Enver Krasniqi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës, konsideroj se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza si dhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit u vërtetua diapozitivi i aktakuzës, si dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ta ketë parasysh pranimin e fajësisë.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ndiej veten fajtor, ndiej keqardhje për të dëmtuarit, jam interesuar për shëndetin e të dëmtuarit A.K. dhe e kam vizituar, i premtoj gjykatës se në të ardhmen do të jem shumë i kujdesshëm, më ka ndodhur për herë të parë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata duke mos u kufizuar me kualifikimin e veprës penale nga prokuroria, bën rikualifikimin e veprës penale duke ja shtuar nenit 297 të KPK-së edhe paragrafin 3, ku përcaktohet pakujdesia, ashtu që kualifikimi i veprën penale duhet të jetë Rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPK-së, e po ashtu sipas detyrës zyrtare ja shton edhe dispozitën blankete, në përshkrimin e gjendjes faktike në dispozitiv, përkatësisht nenin 46 të LPSKRR-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, me shkeljen e nenit 46 të LPSKRR-së, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPRK-së, gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, e për këtë edhe e shpalli fajtor.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 64 të KPK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit dhe ndien shumë keqardhje për të dëmtuarit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike të dëmtuarit u morë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle u morë në bazë të nenit 453 par.4 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1056/2012 më dt.01.06.2015

Sekretarja juridike
Mihrie Sheholli

Gjyqtari vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.